

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zenel Leku - kryetar i kolegjit, Qerim Ademaj dhe Rafet Haxhaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses KEK- Distrikti në Ferizaj, kundër të paditurit N.T., nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, për shkak të kompensim dëmit, vlera e kontestit 883.20€, duke vendosur sipas ankesës të të paditurit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, me numër C.nr.186/11, i datës 17.10.2013 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit N.T., nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan, numër C.nr.186/11, i datës 17.10.2013, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, numër C.nr.186/11, datë 17.10.2013, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit KEK-u, komuna e Ferizajt, kundër të paditurit N.T., nga fshati ..., komuna e Lipjanit, që në emër të dëmit të shkaktuar, paditëses t'i paguajë shumën prej 883.20€ si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30€, të gjitha këto më afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi i paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke mos përmendur asnjërin nga bazat e ankesës, mirëpo kundërshtimi ka të bëjë me atë që ai nuk e ka bërë e as që do të bënte një veprim të tillë për shkak të moshës së tij 78 vjeçare dhe ka kërkuar që ankesa të merret parasysh pasi që aktgjykimi është i padrejtë dhe i pa bazuar në fakte.

Pala paditëse nuk ka dhënë përgjigje në ankesën e palës së paditur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse me datë 29.06.2011, në Gjykatën komunale në Lipjan – tani Degë e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, N.T., nga fshati ..., komuna e Lipjanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësit t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar për shkak të kryerjes së veprës penale të vjedhjes së energjisë dhe atë në vlerën prej 883.20€. Të gjitha shumat e kërkuara më lartë duhet të paguhesh në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë jashtë seance ka marrë aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë dhe atë pasi që i paditurit nuk ka dhënë përgjigje në padi edhe pse gjykata ja ka dhënë mundësinë dhe ka pritur afatin ligjor për dhënien e përgjigjes në padi. Në arsyetim të aktgjykimi gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në bazë të nenit 150 al.1 të LPK dhe pasi që janë shqyrtuar të gjitha provat që janë në lëndë, janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, gjë që gjykata më e lartë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të dispozitës së nenit 194 të LPK-së

Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në pajtim me dispozitën e nenin 150.1 të LPK, më të cilën është përcaktuar se: *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: “a) po që se të paditurit, i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b)po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c)po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”.*

Në rastin konkret rezulton se të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi, mirëpo i padituri brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 15 ditësh nuk ka paraqit përgjigje në padi. Përveç plotësimit të këtij kushti, është plotësuar edhe kushti tjetër dhe atë themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e paraqitura në padi dhe provat të cilat janë paraqitur nuk janë në kundërshtim me këto fakte. Me aktgjykimin P.nr. 179/2009, formës prerë të datës 17.06.2009, vërtetohet se këtu i padituri në këtë çështje penale është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes përkatësisht është konstatuar se i njëjti është kyçur në rrjetin elektrik pa njësor në atë mënyrë që rryma e shpenzuar nuk është regjistruar fare, dhe me këtë rast KEK-ut Divizioni i rrjetit Ferizaj i është shkaktuar dëm në vlerë prej 883.20€.

Përveç këtij aktgjykimi në shkresat e lëndës është edhe fatura në emër të të paditurit datë 31.12.2008, që vërteton lartësinë e dëmit në këtë shumë. Të gjitha këto faktet dhe prova të paraqitura dëshmojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitën ligjore të nenit të sipërcituar me rastin e marrjes së aktgjykimin për mosbindje. Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja e çështjes e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë përkitazi me themelësinë e kërkesëpadisë është në pajtim me dispozitat e LMD- përkatësisht nenin 154 paragrafi 1 i LMD-së që përcakton bazën e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 4906/2014, me datë 06.09.2017

Kryetari i kolegjit
Zenel Leku, d.v